

«Zot, më ndihmo sot!»

(Mateu 6:34)

Ne jetojmë në kohë të vështira, të cilat krijojnë shumë shqetësime për ne. Çdo ditë ballafaqohemi me gjithfarë problemesh: probleme ekonomike, probleme familjare, probleme shëndeti, kriza morale, dhembje për humbjen e një të afërmi apo të njohuri, konflikte kombëtare dhe ndërkombëtare e të tjera si këto. Të gjitha këto vështirësi, të marra së bashku, mund të na sëmurin. Preokupimi i madh me problemet e jetës mund të na shkaktojë ndonjë sëmundje kronike. Mund të preokupojemi kaq shumë me problemet e jetës, sa mund të humbasim vetëkontrollin me shumë lehtësi dhe, në këtë mënyrë, e bëjmë të vështirë edhe jetën e njerëzve të tjerë përreth nesh. Shumë veta, kur ballafaqohen me kaq shumë probleme, thonë: «Unë kam kaq shumë për të bërë, sa nuk e di nga t'ia filloj!» Vetë mbijetesa mund të bëhet një problem i madh për njeriun.

Këto probleme nuk qenë të padëgjuaara për shkrimtarin e librit të Psalmeve. Te Psalmeve 116:3 thuhet: «Fatkeqësia dhe dhembja më kishin vënë përfund.» Në fakt, disa personazhe nga Bibla i kuptuan ashtu siç duhet këto probleme: Jakobi i përshkroi 130 vitet e jetës së tij te Faraoni si «të pakta dhe të këqija» (Zanafilla 47:9). Moisiu e kaloi një pjesë të jetës së tij «duke u rraskapitur» nga detyrat e vështira që kishte (Eksodi 18:13–23). Jobi e përshkroi jetën e tij si «të shkurtër dhe me plot shqetësime» (Jobit 14:1). Rezultati i predikimit të Jeremisë ishte «turp dhe tallje çdo ditë» (Jeremia 20:8). Jeremia u dekurajua kaq shumë sa tha: «Mjerë unë, o nëna ime sepse më ke lindur si një njeri grindjesh dhe sherri» (Jeremia 15:10).

Jezusi na dha disa këshilla të mrekullueshme, që na ndihmojnë t'i përballojmë problemet më me lehtësi: «Mos u brengosni, pra, për të nesërmen, sepse e nesërmja do të kujdeset vetë për vete. Secilës ditë i mjafton pikëllimi i vet» (Mateu 6:34). Për shumë nga ne është më e lehtë që ta mësojmë përmendësh këtë këshillë, sesa ta vemë në praktikë.

Për shumë njerëz, çdo ditë ka mjaft telashe, sa ata nuk mendojnë për të nesërmen. Pyetjet e tyre janë: «Çfarë mund të bëjmë sot?», «Si mund të na ndihmojë Perëndia që të kemi paqe dhe gëzim sot?», «Si do të na ndihmojë Perëndia sot për të përballuar problemet dhe shqetësimet tona?» Ata thonë: «Perën-

di, çdo ditë po bëj të pamundurën, por më ndihmo sot!»

Perëndia i dëgjon kërkesat e fëmijëve të Tij dhe i ndihmon ata që të përballojnë jetën e tyre. Shkrimtari i librit të Psalmeve tha: «Perëndia është kështjella e zemrës sime dhe pjesa ime në përjetësi» (Psalmeve 73:26). Davidi këndoi:

Zoti përkrah tërë ata që rrëzohen dhe ngre përsëri në këmbë tërë ata që janë rrëzuar... Zoti është pranë gjithë atyre që kërkojnë, pranë gjithë atyre që e kërkojnë në të vërtetë. Ai kënaq dëshirën e atyre që kanë frikë prej tij, dëgjon britmën dhe i shpëton. Zoti mbron të gjithë ata që e duan... (Psalmeve 145:14, 18–20).

Perëndia u ka bërë shumë premtime të mëdha njerëzve të Tij. Le të shikojmë tre nga këto premtime.

PREMTIMI PËR FORCË

E para, Ai tha: «Unë do t'ju jap forcë» (Isaia 40:28–31). Eric Liddel, atlet i medaljes të artë, e gjeti forcën e tij në këto vargje. Janë të pakët ata njerëz që fitojnë medalje të arta, por janë të shumtë ata që ballafaqohen me probleme dhe që janë heronj me të vërtetë. Ata nuk i ndalojnë përpjekjet e tyre sepse e dinë se Perëndia është me ta.

Fuqia mund të gjendet te Fjala e Perëndisë (të cilën Ai na e ka dhënë në Bibël).

Lum njeriu që nuk ecën sipas këshillës të të pabesëve, që nuk ndalet nga në rrugën e mëkatarëve dhe nuk ulet bashkë me tallësit, por që gjen kënaqësinë e tij në ligjin e Zotit, dhe që mendon thellë ditë e natë mbi ligjin e tij. Ai do të jetë si një pemë e mbjellë gjatë brigjeve të ujit, që jep frytin e tij në stinën e tij dhe të cilit gjethet nuk i fishken; dhe gjithçka bën do të ketë mbarësi (Psalmeve 1:1–3).

Fuqia mund të gjendet te lutja: «O Zot, ti dëgjon dëshirën e njerëzve të përlurur; ti e fortëson zemrën e tyre, veshët e tu janë të vëmendshëm» (Psalmeve 10:17). Kur ballafaqohemi me vuajtje, Perëndia na jep fuqi (1 Pjetër 5:10). Hiri i Perëndisë është me të vërtetë i mjaftueshëm (2 Korintasve 12:7–10). Te Filipianëve 4:13 thuhet: «Unë mund të bëj gjithçka me anë të Krishtit që më forcon.» Ky varg duhet të jetë një burim i madh i kurajos për kristianët që ballafaqohen me vështirësi.

PREMTIMI PËR KUJDESIN PËR TË QENË ME NJERËZIT E TIJ GJITHMONË

E dyta, Perëndia premtoi: «Unë do t'ju mbaj në dorën Time.» Bashkimi i duarve është një gjë e çmuar, kur lutemi përpara se të hamë bukë apo kur shkojmë në spital dhe lutemi me vëllezërit apo motrat tona kristiane që janë të semurë. Miqtë kristianë më kanë dhënë fuqi, kur ata kanë mbajtur dorën time në kohët që zemra ime ka qenë e copëtuar. Miqtë e mi më kanë ndihmuar shumë, por ndihma e tyre ka një kufi. Atë që nuk e bëjnë dot miqtë e mi e bën Perëndia! Ne lexojmë:

Mos ki frikë, sepse unë jam me ty. Mos e humb, sepse unë jam Perëndia yt. Unë të forcoj dhe njëkohësisht të ndihmoj dhe të mbaj me dorën e djathtë të drejtësisë sime (Isaia 41:10).

Perëndia nuk është larg nga njerëzit e Tij. Ai është gjithmonë me ta, duke bërë atë që asnjë tjetër s'mundet.

A e keni menduar ndonjëherë se çfarë do të thotë që të jesh në duart e perëndisë? Me duart e Tij Ai krijoi botën dhe e solli Izraelin jashtë Egjiptit. Duart e Tij të japin ushqim, të japin për të pirë dhe të ngrënë kur rrëzohesh. Jezusi me duart e Tij pastroi lebrozët, ringjalli vajzën e Jairusit dhe shpëtoi Pjetrin nga mbytja. Ai, gjithashtu, është i gatshëm t'ju shpëtojë nga mëkatet tuaja. Pra ky është Perëndia në duart e të cilit ju jetoni. Jezusi premtoi: «Askush nuk mund t'i rrëmbejë nga dora e Atit tim» (Gjoni 10:29). Perëndia dëshiron të qëndrojë me ju dhe asnjë nuk mund ta ndryshojë këtë fakt, përveç jush! Kur mendoni se jeni mposhtur nga rrethanat e jetës, lutuni: «Zot, më ndihmo të mbaj mend se nuk ka asgjë që Ju dhe unë nuk mund të përballojmë.»

PREMTIMI PËR DASHURINË

Së treti, Zoti premtoi: «Unë do t'ju dua përgjithmonë.» Ne lexojmë:

Por mirësia e Zotit vazhdon nga përjetësia në përjetësi për ata që kanë frikë prej tij, dhe drejtësia e tij për bijtë e bijve, për ata që respektojnë

besëlidhjen e tij dhe mbajnë në mendje urdhërimet e tij për t'i zbatuar në praktikë (Psalmeve 103:17–18).

Dashuria e Perëndisë nuk është një dashuri e momentit, por është një dashuri e premtuar nga një Perëndi i drejtë, i cili do ta mbajë Fjalën e Tij. Jeremia shkroi:

Është një hir i Zotit që nuk jemi shkatërruar plotësisht, sepse mëshirat e tij nuk janë mbaruar plotësisht. Përtërihen çdo mëngjes; e madhe është besnikëria jote. «Zoti është pjesa im», thotë shpirti im, «prandaj do të kem shpresë tek ai» (Vajtimet 3:22–24).

Na është premtuar dashuria besnike e Perëndisë dhe kjo dashuri nuk do të na braktisë kurrë. Pali tha se asgjë nuk mund të na ndajë nga dashuria e Perëndisë (Romakëve 8:38–39).

KONKLUZIONI

Tre premtimet e Perëndisë, për fuqinë, për kujdesin dhe për dashurinë, janë të rezervuara vetëm për ata njerëz që kanë frikë nga Perëndia, për ata që e kërkojnë dhe e duan Atë. A mendoni se arsyeja që kaq shumë nga ne jemi të papjekur shpirtërisht është se ne nuk kemi qenë në gjendje të ndërtojmë një marëdhënie të afërt me Perëndinë, një marëdhënie të karakterizur nga dashuria për Të? Shumë kristianë luten shumë rrallë (nëse luten ndonjëherë). Ata e lexojnë Biblën shumë rrallë (nëse e lexojnë atë ndonjëherë) dhe shkojnë në kishë vetëm kur u pëlqen. Shumë kristianë të tjerë janë të dhënë pas fitimit dhe kjo tregon se prioritetet e tyre në jetë janë të gabuara. Ata duken shumë të zënë me punë për t'i kushtuar kohë Perëndisë.

Fuqia nga Perëndia gjendet vetëm kur jeton për Të. Davidi këndoi: «I bekuar qoftë Zoti, që për ditë mbart barrët tona; Ai është Perëndia i shpëtimit tonë» (Psalmeve 68:19). A po e mbart Perëndia barrën tuaj, apo po e mbartni atë të gjithë vetë? Çelësi për të kuptuar Mateun 6:34 gjendet te 6:33: Dedikojani jetën tuaj Perëndisë!

Autor: J. L. May

Marrë nga studimi: "Cili është kuptimi i jetës"

© 2002, 2003 E VERTETA PËR SOT

Të gjitha të drejtat të rezervuara